



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 897/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtuar nga Naim Asllani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtuar nga Naim Asllani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime me shenjën ZL.Anr.897/2017 e datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me është i me datën 10.11.2017, ka pranuar një apel nga Naim Asllani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Shtime i cili pretendon se në vendvotimet 2203e/ 01R dhe 2203e/02D në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja i figurojnë vetëm 6 vota edhe pse është i bindur se ka më shumë vota. Në vendvotimin 2207/01R ka marrë 3 (tri) vota, në vendvotimin 2207/02D ka marrë vetëm 1 (një) votë, në vendvotimin 2212e/ 01 D ka marrë 6 (gjashtë) vota, pretendon se ka më shumë vota në këto vendvotime se ju kanë shpallur në rezultatin përfundimtarë. Po ashtu pretendon se në vendvotimin 2209/01R dhe 2209/02D i mungojnë votat e tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ne apel të parashtguesit të apelit janë të pabazuara pasi që nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me pretendimet e parashtuara në apel.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apellesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.897/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*